



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2941/10 prot.

Datë 19.12.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 1323/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.12.2023 shqyrtoi ankesën me:

- Objekti:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Ylli Myteveli” Pf në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me nr. REF-82257-10-04-2023 me objekt “Materiale për ngrohje dru zjarri” me fond limit 8,203,213.00 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 17- 10-2023 nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Ylli Myteveli” Pf, nr. NIPT L64506003C Lagjja 17, Rruga “Marigo Pozio”, Zona kadastrale 8564, Nr. pasurie 8/218, Korçë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Maliq  
Bulevardi “Rinia
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

*Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23.11.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3643 dhe me nr. 2941/2023 prot., datë 23.11.2023, e operatorit ekonomik “Ylli Myteveli” Pf, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-82257-10-04-2023 me objekt “Materiale për ngrohje dru zjarri” me fond limit 8,203,213.00 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 17-10-2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq.

II.2. Në datën 17-10-2023, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3 Në datën 17.11. 2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të

Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. Ylli Myteveli Pf	7.502.145 lekë	Skualifikuar
2. Kopaci	8.051.435 lekë	kualifikuar

II.4. Në datën .20.11..2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Publikimin e Njoftimit të Fituesit” për procedurën e prokurimit.

II.5. Operatori ekonomik “Ylli Myteveli” SHPK, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, për arsyet si më poshtë:

*Autoriteti Kontraktor Bashkia Maliq ka kërkuar në dokumentet standarde të tenderit përkatësisht Pika 2.3.2. Subjekti duhet të vërtetojë se ka kontratë me Bashkitë për shfrytëzimin e materialit drusor , shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të lëndës drusore dhe sasia e prokuruar të jetë jo më pak se ajo që kërkohet në DST. Ose Të ketë kontratë furnizimi me një subjekt që ka kontratë me Bashkitë për shfrytëzimin e materialit drusor e shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të materialit drusor që mundëson furnizimin me dru zjarri për sasinë që prokurohet. Ose ne rastin e subjekteve të cilat janë tregtues të mallit (objekt prokurimi), nepermjet importit ,duke vertetuar me faturat doganore ose të këne kontrate furnizimi me subjekte të tjera që importojne mallin objekt prokurimi • Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori Ekonomik “Ylli Myteveli” P.F nuk përmbush pikën 2.3.2 të kërkuar ,konkretisht Sasia e kërkuar e druve sipas DST është 1445,5 mst. Operatori Ekonomik ka paraqitur lejen e shfrytëzimit të lëndës drusore ku verteton sasinë e prokuruar 1539m3 e cila është më pak se ajo e kërkuar në DST.*

III.6 . Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 2941/2 prot., datë 24.11.2023 , janë publikuar arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik “Ylli Myteveli” Pf ngre pretendime.

II.7. Me shkresën e ardhur në Sistemin e ankesave Elektronike, protokolluar me tonën me nr. 2941/3 prot datë 04.12.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ylli Myteveli” Pf për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton, se autoriteti kontraktor me vendimin e tij nuk e ka pranuar ankesën.

II.8 Me shkresën nr. 6569 prot, datë 01.12.2023 protokolluar me tonën me nr. 2941/4 prot datë 06.12.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ylli Myteveli” Pf për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton, se autoriteti kontraktor me vendimin nr. 6406/2 prot., datë 01.12.2023, ka refuzuar ankesën.

II.9 Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon shkresën me nr. 2941/5 prot., datë 12.12.2023, Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit ekonomik “Ylli Myteveli” Pf me objekt “Vënie në dijeni” ku citon: *“për sa më sipër Komisioni Prokurimit Publik ju bën të ditur të gjitha palëve të mësipërme, se për një shqyrtim sa më të plotë e objektiv të ankesës ka kërkuar informacion nga palë të treta, dhe në referim të dispozitave të sipërcituara afatet për shqyrtimin e ankesës nr. 2941 prot, datë 23.11.2023 do të ndërpriten deri në mbërritjen e informacionit të kërkuar”*.

II.10 Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon shkresën me nr. 2941/6 prot., datë 12.12.2023, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me lëndë “Kërkesë për informacion”, në lidhje me ankesën dhe objektin e kësaj procedure prokurimi.

II.11. Në datën 18.12.2023, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit i dërgon shkresën me nr. 7374/1 prot, Komisionit të Prokurimit Publik, protokolluar me tonën me nr. 2941/7 prot, datë 19.12.2023, ku informon rreth kërkesës sonë për informacion, dërguar kjo me shkresën nr. 2941/6 prot, datë 12.12.2023.

II.12. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Ylli Myteveli” Pf, se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike: *“Autoriteti Kontraktor Bashkia Maliq ka kërkuar në dokumentet standarde të tenderit përkatësisht Pika2.3.2. Subjekti duhet të vërtetojë se ka kontratë me Bashkitë për shfrytëzimin e materialit drusor , shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të lëndës drusore dhe sasia e prokuruar të jetë jo më pak se ajo që kërkohet në DST. Ose Të ketë kontratë furnizimi me një subjekt që ka kontratë me Bashkitë për shfrytëzimin e materialit drusor e shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të materialit drusor që mundëson furnizimin me dru zjarri për sasinë që prokurohet. Ose ne rastin e subjekteve te cilet jane tregtues te mallit (objekt prokurimi), nepermjet importit ,duke vertetuar me faturat doganore ose te kene kontrate furnizimi me subjekte te tjera qe importojne mallin objekt prokurimi • Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se Operatori Ekonomik “Ylli Myteveli”P.F nuk përmbush pikën 2.3.2 të kërkuar ,konkretisht Sasia e kërkuar e druve sipas DST është 1445,5 mst. Operatori Ekonomik ka paraqitur lejen e shfrytëzimit të lëndës drusore ku verteton*

sasinë e prokuruar 1539m<sup>3</sup> e cila është më pak se ajo e kërkuar në DST, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar në DST, në shtojcën 5 - 6 dhe në shtojcën 7, pika 2.3.2 si me poshtë :

**Shtojca 5.**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

*Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.*

*SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

*Skicimet, parametrat tekniketj:*

*Specifikimi i Materialeve:*

- **Sasia e druve duhet të jetë : 1445,5 m<sup>3</sup>**

- *Drutë duhet të jenë te ndara :*

*dru ahu 722,75 m<sup>3</sup>*

*dru dushku 722,75 m<sup>3</sup>*

- *Te jene te thata*

*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:*

## **Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

### **FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

*Sasia e mallit që kërkohet:*

**- Sasia e druve duhet të jetë : 1445,5 mst**

*- Drutë duhet të jenë te ndara :*

*dru ahu 722,75 mst*

*dru drushku 722,75 mst*

*- Te jene te thata*

*Drute do te dorezohen sipas sasise se kerkuar nga autoriteti kontraktor si me poshte .*

*Bashkia Maliq Qender 1221.5 mst*

*Njesia Administrative Gore 150.5 mst*

*Njesia Administrative Moglice 73.5 mst*

*Afatet e lëvrimet: 12 muaj nga lidhja e marreveshjes kuader.*

<i>Artikulli</i>	<i>Përshkrimi</i>	<i>Shuma</i>	<i>Destinacioni</i>	<i>Periudha e dorëzimit</i>

## **Shtojca 7**

**Kriteri**

2.3.2. Subjekti duhet të vërtetojë se ka kontratë me Bashkitë për shfrytëzimin e materialit drusor, shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të lëndës drusore dhe sasia e prokuruar të jetë jo më pak se ajo që kërkohet në DST.

Ose

*Të ketë kontratë furnizimi me një subjekt që ka kontratë me Bashkitë për shfrytëzimin e materialit drusor e shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të materialit drusor që mundëson furnizimin me dru zjari për sasinë që prokurohet.*

*Ose ne rastin e subjekteve të cilët janë tregtues të mallit (objekt - prokurimi), nepermjet importit, duke vertetuar me faturat doganore ose të këne kontrate furnizimi me subjekte të tjera që importojnë mallin objekt – prokurimi.*

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Ylli Myteveli” ShPK, për përmbushjen e kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur në SPE dokumentacion si më poshtë vijon:

*Leje Shfrytëzimi Nr. 1. Leshuar nga Bashkia Korçe (Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave) me datë 24.04.2023 për operatorin ekonomik “Ylli Myteveli” Pf ku citohet se lejohet të shfrytëzojë ne gastrat si me poshte lëndë Drusore ne këmbë gjithsej m3 (1539 m3.) Kjo leje ka perriudhen e vlefshmerise nga data 24.04.2023, deri në datën 30.09.2023.*

III.1.4. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”*

III.1.6. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet se: “3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.8. Nisur nga arsyeja e skualifikimit dhe nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Ylli Myteveli” Pf , Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga ky operator ekonomik, konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Leje Shfrytëzimi lëshuar nga Bashkia Korçë (Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave), ku lejohet të shfrytëzojë **1539 m3 Lëndë drusore.**



Në kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, si dhe në formularin e specifikimeve teknike janë përcaktuar: **“Sasia e druve duhet të jetë : 1445,5 mst”** dhe **“Subjekti duhet të vërtetojë se ka kontratë me Bashkitë për shfrytëzimin e materialit drusor , shoqëruar me lejen e shfrytëzimit të lëndës drusore dhe sasia e prokuruar të jetë jo më pak se ajo që kërkohet në DST”**.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik për vetë rëndësinë që ka shqyrtimi në kohë i ankesave të operatorëve ekonomikë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i prokurimit publik, si dhe për një shqyrtim më të plotë e objektiv të ankesës, i dërgon shkresën me nr. 2941/6 prot, datë 12.12.2023, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ku kërkon informacion mbi koeficientin e njësisë matëse nga mst në m<sup>3</sup> dhe se sa m<sup>3</sup> bëjnë 1445.5 mst.

Referuar kthim - përgjigjes së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me shkresën nr. 2941/7 prot, datë 19.12.2023, citohet *“Në përgjigje të shkresës suaj nr. 2941/6 prot datë 12.12.2023 ‘‘Kërkesë për Informacion’, Drejtuar Ministrisë se Turizmit dhe Mjedisit’’, ju bëjmë me dije se “Sasia prej 1445.5 mst (metërsterë) është e barabartë me 968.485m<sup>3</sup> (metër kub)*

*Koficientet e njësimimit të sasise nga metërkub në metërsterë jane: 1 m<sup>3</sup> (meterkub) = 1.677 mst (metërsterë)*

*Imst (metërsterë) t= 0.67 m<sup>3</sup> (meterkub)*

Në rastin konkret, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “Ylli Myteveli” PF me dokumentacionin e ngarkuar në SPE, e përmbush kriterin e përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, pasi sasia e kërkuar nga autoriteti kontraktor është **1445,5 mst**, ku në bazë të përgjigjes së Ministrisë së Mjedisit dhe Kulturës është e barabartë me **968.485m<sup>3</sup>** (metër kub). **Operatori ekonomik e tejkalon kërkesën e Autoritetit Kontraktor, pasi atij i lejohet shfrytëzimi prej 1539 m<sup>3</sup> Lëndë drusore**, ndaj bazuar në kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në rastin në fjalë, operatori ekonomik e ka përmbushur detyrimin e tij në përmbushjen e kësaj kërkesë.

Sa me sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. Nr. 236, datë 20.4.2023 *“Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”* i ndryshuar , Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### Vendos:

1. Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “Ylli Myteveli” Pf për procedurën e prokurimit *“E hapur e thjeshtuar”* me nr. REF-82257-10-04-2023, me objekt

“Materiale për ngrohje dru zjarri” me fond limit 8,203,213.00 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 17.10.2023, nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq.

2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Ylli Myteveli” Pf, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ylli Myteveli” Pf.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

